



# **BACHELOR**

## **SHKENCA BUJQËSORE DHE SIGURI USHQIMI**

**NË BASHKËPUNIM ME UNIVERSITETIN BOKU**

# Pse ky program studimi?

Ky program studimi, në bashkëpunim me **Universitetin BOKU**, është krijuar për t'iu përgjigjur në mënyrë të drejtpërdrejtë nevojave aktuale dhe perspektivave të tregut të punës.

Ai u ofron studentëve një formim të plotë teorik dhe praktik në prodhimin bimor dhe shtazor, menaxhimin e qëndrueshëm të fermave bujqësore, akuakulturës dhe zbatimin e praktikave moderne, duke i aftësuar në teknologji dhe metoda inovative për përmirësimin e produktivitetit.

Programi synon zhvillimin e kompetencave profesionale dhe ndërdisiplinore për përballimin e sfidave bashkëkohore të bujqësisë, sigurisë ushqimore dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Të diplomuarit përgatiten për sektorin agro-ushqimor dhe institucionet publike.

**Diplomë që njihet ndërkombëtarisht**



## Përshkrimi i programit

Programi ofron një formim akademik ndërdisiplinor, duke integruar shkencat sociale, natyrore dhe teknike për të zhvilluar njohuri dhe zgjidhje inovative në prodhimin bujqësor, mbrojtjen e mjedisit dhe transferimin e teknologjisë. Strukturimi i krediteve në fusha të ndryshme siguron një balancë mes teorisë dhe praktikës, ndërsa 12 kredite zhvillohen në gjuhën angleze, duke forcuar përgatitjen akademike dhe profesionale të studentëve.



# Profili i të diplomuarit / Profil profesional

Të diplomuarit në këtë program formohen si profesionistë me aftësi teorike, praktike dhe ndërdisiplinare në prodhimin bujqësor, menaxhimin e qëndrueshëm të fermave dhe sigurinë ushqimore. Ata mund të ushtrjnë profesionin si:

- **Specialist/Menaxher** në fermat bujqësore, blegtorale dhe të agroturizmit.;
- **Specialist** në agjencitë e këshillimit bujqësor në strukturat publike ose private,
- **Specialist i sigurisë ushqimore dhe mjedisit**, në institucione monitoruese, agjenci zhvillimi dhe sektorin agro-ushqimor;
- **Ekspert projektsh bujqësore dhe zhvillimi rural**, në organizata kombëtare dhe ndërkombëtare.



**Moltine Prebibaj**

Pedagoge UBT

“Përfaqësoj profilin e akademikut me formim të qëndrueshëm teorik dhe metodologjik në shkencat bujqësore. Pas përfundimit të studimeve Master në IAM Bari, jam angazhuar në mësimdhënie në Universitetin Bujqësor të Tiranës, duke kontribuar në edukimin akademik dhe zhvillimin e kërkimit shkencor.”



**Dritan Sadikaj**

Drejtor “Agrimatco Group”

“Kam përfunduar studimet në Agronomi e Përgjithshme në UBT dhe masterin në Mbrojtje Bimësh në Universitetin Leibniz të Hannover-it, Gjermani. Pas një karriere 10-vjeçare akademike në UBT, prej rreth 15 vitesh jam drejtues (Agrimatco Group) të fokusuar në inputet bujqësore dhe asistencën teknike për prodhuesit.”



**Artan Sota**

Drejtor “AgroArfa sh.p.k.”

“Jam drejtues dhe sipërmarrës në sektorin bujqësor, ku drejtoj kompaninë AgroArfa sh.p.k., të specializuar në zhvillimin, prodhimin dhe tregtimin e farave të drithrave, duke kontribuar në krijimin dhe regjistrimin e varieteteve të reja në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.”



**Elion Ismailaj**

Pedagog UBT

“Jam akademik në Mbrojtjen e Bimëve, me fokus në fitopatologji, mësimdhënie dhe kërkim shkencor mbi diagnostikimin e patogjenëve dhe menaxhimin e sëmundjeve, i formuar në Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe i specializuar në universitete italiane.”

# Kompetencat kryesore të fituara

Në përfundim të programit, studentët fitojnë kompetenca në:

- Shkencat bujqësore dhe sigurinë ushqimore, duke integruar agronominë, hortikulturën, mbrojtje bimësh, zootekninë dhe akuakulturën.
- Zhvillojnë aftësi praktike për kultivimin e qëndrueshëm të bimëve, mbarështimin dhe mirëqenien e kafshëve, mbrojtjen e kulturave nga faktorët biotikë dhe abiotikë, si dhe menaxhimin e sistemeve të peshkimit dhe akuakulturës.
- Forcojnë kompetencat analitike, teknike dhe menaxheriale, të domosdoshme për përballimin e sfidave të sektorit agro-ushqimor.
- Përgatiten për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të prodhimit bujqësor dhe industrisë ushqimore.

## PËRMBAJTJA E STUDIMEVE

### LËNDËT BAZË

Kimia për Shkenca Bujqësore, Biologji për Shkenca Bujqësore, Matematika dhe Statistika për Shkenca Bujqësore, Botanikë e Përgjithshme për Shkenca Bujqësore

### LËNDËT KARAKTERIZUESE

Shkenca e Tokës dhe Gjeologjia për Shkencat Bujqësore, Makineri Bujqësore, Inxhinieri Bujqësore, Prodhimi bimor, Mbrojtje Bimësh, Pomologji, Cilësia e siguria produkteve bujqësore, blegtorale e të peshkimit

### TË TJERA

Ekonomia dhe Politik-bërja në bujqësi dhe Legjislacioni Agrar, Agroekologjia, Meteorologjia dhe Klimatologjia, Administrim i biznesit bujqësor dhe marketing

Mësimdhënia realizohet përmes leksioneve interaktive, seminareve, ushtrimeve praktike dhe punës laboratorike. Programi përfshin punë laboratorike të strukturuar, projekte studimore dhe praktikë profesionale të detyrueshme.

## Mundësi Punësimi:

- Në fermat e vogla, të mesme dhe të mëdha me prodhim bimor dhe blegtoral, duke aplikuar praktika të qëndrueshme prodhimi.
- Pozicione në tregti dhe shpërndarje të inpleteve bujqësore, si fara, plehra dhe produkte për mbrojtjen e bimëve.
- Punësim në sistemin publik dhe privat të këshillimit bujqësor dhe agjencitë/ institucionet publike përgjegjëse qendrore, rajonale apo edhe bashkiake.
- Punë në organizatat joqeveritare që veprojnë në zhvillim rural, mjedis dhe siguri ushqimore.

# Të dhënat e programit

## **Niveli i studimit**

Cikli i parë, Bachelor

## **Titulli akademik**

Bachelor në Shkenca Bujqësore dhe Siguri Ushqimi

## **Kohëzgjatja**

3 vite akademike / 6 semestra

## **Kredite**

180 ECTS

## **Forma e studimit**

Me kohë të plotë

## **Gjuha e studimit**

Shqip / Anglisht

## **Kuota studimi**

100 studentë

## **Përfundimi i studimeve**

Provim formimi / Temë diplome



# Rreth UBT

Universiteti Bujqësor i Tiranës u themelua më 1 nëntor 1951 dhe prej vitit 1956 është vendosur në Kodër Kamëz. Që nga krijimi, ai ka qenë një shtyllë e arsimit dhe kërkimit bujqësor në Shqipëri.

Sot, UBT luan një rol kyç në bujqësinë e qëndrueshme, sigurinë ushqimore dhe zhvillimin rural, duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar përmes partneriteteve strategjike, përfshirë Universitetin BOKU të Vjenës.



## Për më shumë informacion vizitoni:

[www.ubt.edu.al](http://www.ubt.edu.al)

[info@ubt.edu.al](mailto:info@ubt.edu.al)

Rruga "Pajsi Vodica" Tiranë

## MUNDËSI VAZHDIMI STUDIMESH (MASTER)

Pas përfundimit të studimeve Bachelor, të diplomuarit mund të vazhdojnë studimet Master në fusha si Shkencat Agronomike, Hortikultura, Mjekësia Bimore, Shkenca Zooteknike, Akuakultura dhe Peshkimi, duke u përgatitur për role kërkimore, menaxheriale dhe teknike në sektorin bujqësor dhe ushqimor.

## FOLLOW US ON SOCIAL MEDIA



Agricultural University of Tirana



universiteti\_bujqesor\_tiranes  
fbm\_ubt



Universiteti Bujqësor i Tiranës - Faqja Zyrtare  
Fakulteti I Bujqësisë dhe Mjedisit- Faqja Zyrtare

*Për jetën dhe të ardhmen...*